



Nr. 10 Prot.

Tirane, më 05.06.2024

VENDIM

Nr.10, datë 05.06.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.8, DATË 03.06.2024 “PËR REGJISTRIMIN DHE SHPALLJEN E KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, SI DHE ANËTARË TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, UPT” TË NDRYSHUAR

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Senatit Akademik të UPT me Nr. 10, datë 28.03.2024 “Për miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024-2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës” neni 18, neni 21-25, Udhëzimin Nr. 1, datë 23.05.2024 të KIZ “Për shpalljen e afateve të kandidimit, si dhe dorëzimin e dokumentacionit për drejtues të njësive kryesore, drejtues të njësive bazë, si dhe anëtarëve të komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, Vendimin nr. 7, datë 31.05.2024 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të FIN “Për marrjen në dorëzim të dokumentacionit dhe regjistrimin e kandidatëve për drejtues të njësive kryesore, drejtues të njësive bazë, si dhe anëtarë të komisioneve të përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit”, Vendimin nr. 9, datë 04.06.2024 “Për Çregjistrimin e Kandidatëve për Drejtues të Njësive Bazë në Departamentin e Inxhinierisë së Mjedisit, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, UPT” si dhe Vendimin nr. 1, datë 24.05.2024 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit “Për konstituimin e Komisionit të Zgjedhjeve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit”, në mbledhjen e datës 05.06.2024 Komisioni Zgjedhor i FIN,

VENDOSI

1. Të shqyrtojë dokumentacionin e kandidatëve për Drejtues të Njësive Kryesore, Drejtues të Njësive Bazë, si dhe Anëtarë të Këshillit të Profesorëve në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, sipas listës së Procesverbalit date 31.05.2024 të firmosur nga Kryetari i KZF-FIN si dhe Kryetari dhe Sekretari i KIZ-UPT dhe Vendimin Nr. 9, datë 04.06.2024 të Komisionit

Institucional të Zgjedhjeve në UPT “Për Pranimin e Kërkesës për Çregjistrim të Kandidatëve për Drejtues të Njesisë Bazë”.

2. Të vlerësojë të plotë dhe të rregullt dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe të marrë në dorëzim nga KIZ – UPT, sipas kërkesave të legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024-2028 në Universitetin Politeknik të Tiranës, Udhëzimeve dhe Vendimeve të KIZ-UPT.

3. Të regjistrojë dhe të shpallë kandidatët për Dekan (drejtues të njësisë kryesore) në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, si më poshtë:

- Neritan SHKODRANI
- Igli KONDI

4. Të regjistrojë dhe shpallë kandidatët për drejtues të njësisë bazë, për secilin nga Departamentet e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, si më poshtë:

A. DEPARTAMENTI I KONSTRUKSIONEVE TË NDËRTIMIT DHE INFRASTRUKTURËS SË TRANSPORTIT (DKNIT)

- Arian LAKO

B. DEPARTAMENTI I MENAKIKËS SË STRUKTURAVE (DMS)

- Irakli PREMTI

C. DEPARTAMENTI I HIDRAULIKËS DHE HIDROTEKNIKËS (DHH)

- Nuk ka kandidat

D. DEPARTAMENTI I INXHINIERISË SË MJEDISIT (DIM)

- Nuk ka kandidat

E. DEPARTAMENTI I GJEODEZISË (DGJ)

- Bilbil NURÇE

5. Të regjistrojë dhe shpallë kandidatët për anëtarë të Komisioneve të Përhershme për Dhënie të Gradës Shkencore “Doktor” në Universitetin Politeknik i Tiranës, si më poshtë:

- Neritan SHKODRANI
- Elfrida SHEHU
- Oltion MARKO
- Konalsi GJOKA
- Igli KONDI
- Julian KASHARAJ
- Altin BIDAJ
- Bilbil NURÇE
- Markel BABALLËKU

6. Një kopje e vendimit i përcillet KIZ.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I ZGJEDHJEVE I FIN

Enio DENEKO

Kryetar

Freskida ABAZAJ

Anëtar

Santino SPAHIU

Anëtar

Eduart BLOSHMI

Anëtar

Kleant SEMEMA

Anëtar

Marjo HYSENLLIU

Anëtar

Ibiana MUÇA

Anëtar

Sekretare KZF – FIN

Elmira HYKA